

Nexhmedin (Sadik) Bedra

(11.09.1948, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, afarist, dy fëmijë)

Nexhmedini ka qenë drejtor i ndërmarrjes private për përpunimin e tekstit *Triko X* në Gjakovë/Đakovica, e cila prodhonte kapela dhe trikotazh për pjesëtarë të UÇK-së. Në datën **2.12.1998**, Nexhmedini me të birin Meritonin dhe kolegun Ymer Lilan u nisën për në Prishtinë, për tu furnizuar me penjtë që shfrytëzoheshin si lëndë e parë për prodhim. Udhëtonin me një furgon privat. Në kthim, përderisa po kalonin nëpër fshatin **Dollc/Dolac**, i cili ishte nën kontrollin serb, një burrë i maskuar ka hapur zjarr ndaj tyre nga një bjeshkë. Një plumb e ka qëlluar Nexhmedinin në kërdrhokull. Plaga ishte vdekjeprurëse dhe Nexhmedini dha shpirt në duart e Ymerit. Vdekjen e Nexhmedinit e kanë konfirmuar edhe mjekët në spitalin e Gjakovës/Đakovica, në prani të policisë serbe. Nexhmedini e kanë varrosur në varrezat e qytetit në Gjakovë/Đakovica, më 4.12.1998.

Burimet: deklarata Y.L, FDH-34983; deklarata I.B, FDH-33472; SMIP, *Teroristički...*, III, 262, 695; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX. D298.2.3, FDH-30924; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Gani (Azem) Agushi

(4.09.1946, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtimor)

Ganiu me familje u arratisën nga shtëpia e vetë në Drenoc/Drenovac më 28.06.1998, kur forcat serbe e sulmuan fshatin. Fillimisht, u strehuan në fshatin Jabllanicë/Jablanica [Gjakovë/Đakovica]. Pas dy ditësh, familjarët e Ganiut shkuan në Cerovikë/Cerovik, ndërkaq Ganiu mbeti në Jabllanicë/Jablanica, ku u ndihmonte pjesëtarëve të UÇK-së pranë shtabit lokal. Punonte në kuzhinë. Në njërën prej mbrëmjeve, nga mesi i muajit dhjetor të vitit 1998, Ganiu u nis për në **Drenoc/Drenovac**, për ta kontrolluar shtëpinë e vet. Me të arritur atje, e zunë dhe e burgosën disa të rinj serb që ishin të veshur në uniforma policore. E mbajtën tri ditë. E rrihnin dhe me thikë e thernin nëpër trup, duart dhe fytyrë, ndërkaq në fund e gjuan jashtë në borë. Ganiu arriti që të shkonte deri në Përqevë/Prčevovo, te motra e tij. Ishte i fryrë nga të rrahurat dhe lëndimet. Pas disa ditësh, më **25.12.1998**, ai ndërroi jetë nga lëndimet e rënda. Po atë ditë, e varrosën në një pyll në afërsi të fshatit. Pas përfundimit të luftës, më 20.07.1999, familjarët i kanë riarrosur mbetjet mortore të Ganiut në varrezat e Drenocit/Drenovac.

Burimi: deklarata G.A, FDH-19337.